

PROJEKTZBATIMI

AUTORITETIKONTRAKTUES:BASHKIATROPOJE



BASHKIA TROPOJE

RAPORT TEKNIKE – PUNIME NDERTIMI

OBJEKTI : RIKONSTRUKSION I KANALEVE VADITSE
BASHKIA TROPJE **2023**

Skemat e Ujitjes së Bashkisë Tropojë

Hyrje

Studimi është realizuar për të gjitha kanalet kryesore të rrjetit vadites egzistues për kjo për punimet më të nevojshme (apo më të domosdoshme) lidhur kjo edhe me mundësit financiare dhe Projekt Buxhetin e Bashkisë Tropojë për vitin 2023

Ky raport do të trajtojë problematikat teknike të skemes së ujitjes dhe rehabilitimitin e saj. Ky raport do të ndërtohet mbibazën e pikave të mëposhtme:

- Planifikimi dhe investigim në terren.
- Permisimi i skemes së ujitjes egzistuese.
- Rehabilitimin e kanaleve kryesore të fshatrave.
- Riparimi i strukturave apo veprave të artit në kanalet kryesore.

Rehabilitimi i kësaj skeme sjellë një permisim të ndjeshëm në bujqësinë e zonës, duke rritur prodhimtarinë dhe duke lehtësuar punën e fermerëve. Në këtë projekt do të rishikohet permiresimi i skemes së ujitjes.

Zona e Projektit

Projekti ndodhet në zonën veriore të Shqipërisë, në Bashkinë Tropojë e cila bën pjesë në Rrethin e Tropojës. Si njësi administrative ajo përfshihet në qarkun e Kukësit. Qyteti i Bajram Currit është qendra më e rëndësishme administrative dhe funksionale e rrethit të Tropojës. Qyteti rrethohet nga fshatrat e Njesive Administrative Margegaj dhe Bujan .

Rrugët e aksesit në zonën e projektit

Për të arritur në zonën e projektit përdoren rrugët nacionale B.Curri –Valbone, B.Curri-Kam, B.Curri - Fierze si dhe rrugët që lidhin njësit Administrative me rrugët Nacionale. Në zonën në studim ka disa rrugë që kalohet me mjete siç janë Kanali i Gashit dhe kanali i Krasniqes.

Objektivat e Studimit

Objektivat Madhore

Zhvillimi i projektit rikonstruksionit të kanaleve vadites në Bashkinë Tropojë është shumë i rëndësishëm për ujitjen e tokave bujqësore.

Nga këto kanale me parrë vaditej një sipërfaqe toke prej 4820 Ha. Aktualisht si rezultat i demtimeve në periudhën e tranzicionit shumë kanale janë shkatëruar dhe në punimet që do të realizohen në këtë sezion këtyre nuk janë të parashikuara për rehabilitim ku vlen për të theksuar se vetëm kanali i Gashit kërkon një investim mbi një miliard lekë.

Në përgjithësi në këtë zonë ka rreshje të bollshme të cilat mjaftojnë për bimën që të zhvillohet normalisht. Problemi madhore qëndron gjatë periudhës së thatë ku burimet ujore në zonë thuhet se thahen dhe nuk ka asnjë mundësi shfrytëzimi për ujtje.

Objektivat specifik

Përfitimet e tjera që mund të pritët të shfaqen me fillimin e projektit janë:

- Efikasiteti i përmirësimit të përdorimit të ujit;
- Përmirësime të përfitimeve të sigurisë ushqimore / ushqimore lokale;
- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve natyrore (tokës dhe ujit);
- Rezistenca ndaj rrezikut të thatësisë;

Qellimi i Projektit

- Projektimit i ujitjes duhet të sigurojë besueshmërinë dhe fleksibilitetin e furnizimit me ujë të fermerëve.
- Azhurnimi i gjendjes ekzistuese, nëse është e disponueshme, llogaritja e avullim-traspirimit aktual, kërkesës për ujë, kërkesës/detyra për ujitje duke përdorur të dhënat ekzistuese dhe të fundit agronomike, klimatologjike dhe tokës duke përdorur metodologji më të përshtatshme
- Vendosja e kriterit të projektimit për strukturat e ujitjes
- Hartimi i sistemit të duhur të ujitjes në përputhje me kushtet lokale dhe aftësitë e menaxhimit,
- Vendosja e masave për mbrojtjen nga përmbytja për zonën e komanduar
- Planifikimi dhe paraqitja e sistemit të ujitjes, të cilat përfshijnë kanalet e ujitjes, rrugët e shërbimit dhe shtrirjet, hapësirat e kanalit, gjatësinë e kanalit, vendndodhjen e strukturave, dhe profilet e ujit përgjatë kanalit.
- Përcaktimi dhe vlerësimi i bartjes së aplikimit të ujit dhe humbjeve të tjera dhe efikasiteteve të ujitjes dhe konsiderimi i këtyre parametereve në hapat e projektimit.
- Kontrollimi dhe testimi i modeleve hidraulike dhe strukturore të kanalit kryesor duke marrë parasysh kërkesën totale dhe kapacitetin e kërkuar dhe disponueshmërinë e rrjedhës bazë,
- Përgatitja e planeve dhe vizatimeve të përgjithshme për të gjitha projektet e infrastrukturës vaditëse

Metodologjia

Në procedurën e studimit për hartimin e projekt – preventivit, përdorën hapat e mëposhtëm.

- Identifikimi i terrenit:
 - o Vizite në terren
 - o Harta e shkallës më të lartë 25,000 dhe informacioni GIS
 - o Intervistë dhe diskutim i fermerëve lokalë;

Per venjen ne pune per vitin 2023 te Kanalit Koçanaqe nga Vepra e marrje gjere te qendra e ishe Komunes Margegaj kerkojen keto proçese pune:

1. Ne pjesen e fillimit te kanalit eshte demtuar muri ne pjesen e poshtme (3x0.6x0.5)
 - Mure guri 3 m x 0.6 m x 0.5 m
 - Suvatim muri 3 m x 0.6 m
2. Heqja e materialit te mbushur nga lumi 80 m x 0.8 m x 0.6
3. Demtim i murit perballe rruges makines ne pjesen me te afert
 - Mure guri 11 m x 1.2 m x 0.4 m
 - Suvatim muri 11 m x 0.8 m
 - Shtrese betoni 11 m x 0.8 m x 0.1 m
4. Devijimi i kanalit me germim dhe ndertimi i murit ne dy anet sipas seksionit ekzistues te kanalit (20 x 1.5 x 0.4) dhe (20 x 1.2 x 0.4).
 - Germim dheu 20 m x 0.8 m x 1 m
 - Germim dheu per themel 20 m x 0.4 m x 0.4 m
 - Ndertim mure guri 20 m x 1.2 m x 0.4 m
 - Suvatim mure guri 20 m x 0.8 m
 - Germim dheu per themel 20 m x 0.5 m x 0.4 m
 - Ndertim mure guri 20 m x 1.5 m x 0.4 m
 - Suvatim mure guri 20 m x 0.8 m
 - Shtrese beton 20 m x 0.8 m x 0.1 m
 - Transport materiali me kafshe 5 km
5. Mbushja e kanalit nga kanli i Krasniqes
 - Germim materiali (16 x 8 x 1.2)
 - Ndertimi mure guri.(16 x 1.2 x 0.4).
 - Suvatim mure guri 16 m x 0.8 m
 - Shtrese betoni 16 m x 0.8 m x 0.1 m
6. Kanali ne gjithe gjatesin duhet te pastrohet nga puntore.

FOTO VEPRA E MARRJES SE Kanallt KOÇANAJE Viti 2023



FOTO DEMENTIMI I MURIT TE Kanallt KOÇANAJE Viti 2023



**FOTO DEMENTIMI I KANALIT KOÇANAJE nga shemja e Kanalit te KRASNIQES Viti
2023**









Per venjen ne pune per vitin 2023 te Kanallt Shoshan ne zonen e rreshqitjes

se nje pjese te kanalit se bashku me tubacionin fi 400 mm :

1. Ndertimi i ames (vepres marrjes) pasi eshte demtuar plotesisht nga lumi.
2. Eshte e domosdoshme germimi ne nje gjatesi 96 ml per te krijuar trasen e rregullt dhe pasi te vendosen kuotat niveluese te vendosen tubat 400 mm ekzistues.
 - Jane gjendje 72 ml tube dhe kerkohen dhe 36 ml
 - Mure beton ne hyrje dalje te tubit.
3. Mure guri te shemja afer vigit vakes 10 m x 1.2 m x 0.4 m
 - Germim per themel 10 x 0.4 m x 0.4 m
 - Suvatim mure guri 10 m x 0.8 m
 - Shtrese betoni ne kanal 10 m x 0.4 m x 0.1 m
 - Transport materiali me kafshe 2 km
4. Kanali ne gjithe gjatesin duhet te pastrohet nga puntore.

FOTO DENTIMI I KANALIT SHOSHANIT ne seksionit te tubacloneve fl 400 mm nga reshqitja e tokes Viti 2023









Per venjen ne pune per vitin 2023 te Kanalit GASHIT nga Vepra e marrjes gjere ne Hyrja te fshatit Begaj (lagjla DREJTOV) kerkojen keto proçese pune:


1. Lidhja e ames(vepres marrjes) pasi eshte demtuar nga lumi sipas projektit.
2. Ndertimi i murit te demtuar nga lumi ne afersi te vepres marrjes sipas projektit.
 - Mure betoni 8 m x 2 mx 0.7 m
 - Shtrese betoni 7 m x 1.4 m x 0.15 m
 - Transport materiali me kafshe 5 km
3. Germim me krahe per trasen e vendosjes se tubave 500 mm *(dy tuba krahas)*
 - 80 ml x 2.6 m x 0.8 m.
4. Vendosjen e tubave ne gjithe gjatesin e trasese ,lidhjen mes tyre me gomina etj...
5. Ndertim mure betoni mbi tuba ne hyrje dhe dalje.
6. Pastrimi i kanalit nga vepra e marrjes gjere ne lagjen Drejtove gjatesi 7.5 km.

FOTO VEpra E MARRJES SE Kanallt GASHIT Viti 2023



FOTO DEMENTIMIT ne zonen e Mal Rrafshit si rezultat I rreshqitjes se tokes
Kanalit GASHIT Viti 2023





Per venjen ne pune per vitin 2023 te Kanalit Krasniqes nga Vepra e marrje gjere te Hyrja e sifonit mbi lumen e Valbones kerkohen keto proçese pune:

1. Zhbllokimi i hyrjes se tunclit pasi eshte bllokuar nga materiale te sjella nga lumi.
2. Ndertimi i ames (vepres marrjes) pasi eshte demtuar plotesisht nga lumi.
3. Ndertimi i murit krahu i poshter i demtuar nga shkeputja e nje masivi shkembi
(7 x 1.5 x 1) dhe (7 x 1.5 x 0.5) ml.
 - Mure guri me dy shkallezime i pari 7 m x 1.5 m x 1 m dhe i dyti 7 m x 1.5 m x 0.5 m
 - Suvatim mure guri 7 m x 1.2 m
 - Shtrese betoni 7 m x 1.4 m x 0.1 m
 - Germim per themel 7 m x 1 m x 0.4 m
 - Transport materiali me kafshe 2 km
4. Ne kete gjatesi kanali ka material ne sasi te vogla si gure lende drysore etj ..te cilat duhet te hiqen me puntore.

FOTO VEPRA E MARRJES SE Kanallt KRASNIQES Viti 2023




FOTO DEMENTIMI I MURIT TE Kanallit KRASNIQES Vitit 2023



- o Takim me grupet e interesit
- Vleresimi i prurjes
 - o Vëzhgimi fizik i zones se projektit per te vezhguar problematikat kryesore qe ka kanali i ujitjes, menyren e operimit te tij etj.
- Identifikimi i zones se ujitjes
 - o Perdorimi i infomacionit lokal
 - o Harta topografike 25,000 dhe informacioni I GIS.
 - o

Pershkrimi i Pergjithshem

Kanalet i ujitjes ne Studim ujitin tokat me sistem me gravitet, kanë një gjatesi prej me shume se 100 km. Kanali Begaje me nje gjatsi 18 km furnizohet nga lumi i Gashit dhe ka nje kapacitet maksimal prej 1000 l/sek. Kanali i Krasniqes ka nje gjatesi prej 14 km furnizohet nga Lumi i Valbones dhe ka nje kapacitet maksimal prej 1400 l/sek. Krahas ketre dy kanaleve qe eituam me larte ne Bashkin Tropoje jane edhe nje numer i madhë kanal;esh ne njesit Administrative qe parashikohet te riparohen ku pu pershkruajm disa prej tyre:

- Kanali i Cernices
- Kanali i Tabakve
- Kanali i Shoshanit
- Kanali Mahall e Eper Zogaj
- Kanali i Llugajve
- Kanali i Bukoves
- Kanali i Sopotit
- Kanali i Vladit
- Kanali i Dragobis
- Kanalet Lekbibaj

E kanele tyjera qe vaditin tokat e fermerëve te rrethit Tropoje.

Infrastruktura e Kanalit Ujitjes dhe gjendja egzistuese

Nga vezhgimet ne terren te grupi te punes rezultoi u verejt se kanalet ujitesse kane pesuar demtime, kane bllokime te shumta si dhe veprat eartit jane ne shume vende te dantuar.

Kanalet kryesore ne pergjithesi jane jane me shtresa betoni.

Momentalishte jane parashikuar punimet per riparimin e Veprave te Artit te demtuara dhe ne disa raste ne kanale te vogla edhe kalime me tuba te brinjezuar, ndersa ne Kanalin Lekbibaj eshte parashikuar tubi PE Ø 50mm per nje gjatesi 1000 ml. Te gjitha punimet duhet realizohen sipas Kushteve Teknike te Zbatimit dhe ne perputhje me Specifikimet Teknike.

GRUPI I PUNES
Ing. Egzon Muhametaj

Tek.Agim Demiraj

Top.Muhamet Kuçana